

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"
SENATI AKADEMIK

Nr. 24 Prot.

Vlorë më, 02. 03. 2017

V E N D I M

Nr. 27, datë 02. 03. 2017

Bazuar në nenin 30 e 38, pika 1, gërma "d", dhe 82 të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë*"; nenet 98 e 99 të Ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë*"; si dhe në nenin 9, pika 2, të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Senati Akademik i Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV);

V E N D O S I:

1. Të miratojë **Rregulloren** për "*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*".
2. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet KUPV dhe Universitetit Sapienza Romë/Itali, për bashkëpunim të ndërsjelltë në fushën akademike dhe kërkimore shkencore. Marrëveshja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe protokollimit nga Palët.
3. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit (Nr. 14 Prot., datë 16.02.2017) ndërmjet KUPV dhe Gjimnazit Jopublik "PERLA" Vlorë, "*Për shfrytëzim të mjediseve individuale, të laboratorëve të informatikës, mjediseve sportive, bibliotekës, sallës së konferencave*".
4. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit (Nr. 23 Prot., datë 28.02.2017) ndërmjet KUPV dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë, "*Për bashkëpunim në fushën e Trashëgimisë Kulturore*".
5. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet KUPV dhe Kolegjit Universitar "Luarasi" Tiranë, për bashkëpunim të ndërsjelltë në fushën akademike e kërkimore shkencore. Marrëveshja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe protokollimit nga Palët.
6. Të miratojë shfuqizimin e Pikës XI të Vendimit nr. 23, datën 16.12.2016 të Senatit Akademik, lidhur me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

7. Të miratoj strukturën e Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me këtë përbërje:
 - a. Msc. Anduel MEHMETI - Kryetar
 - b. Msc. Fabiola DELIAJ - Anëtar
 - c. Msc. Jezerca HODAJ - Anëtar
 - d. Adelajda FEJZAJ - Anëtar (Studente)
 - e. Msc. Ervin SKËNDERI - Anëtar (Ekspert i jashtëm).

8. Të miratoj shquqizimin e Pikës VIII të Vendimit nr. 23, datën 16.12.2016, të Senatit Akademik, lidhur me strukturën e Këshillit të Etikës.

9. Të miratoj strukturën e Këshillit të Etikës, me këtë përbërje:
 - a. Dr. Jeta GOXHA - Kryetar
 - b. Msc. Saniela XHAFERI - Anëtar.
 - c. Dr. Mallëngjim SKËNDERAJ - Anëtar.
 - d. Dr. Merita MURATI - Anëtar.

10. Të miratoj ndërtimin dhe funksionimin e **UMS** (University Management System) për menaxhimin e informacioneve të studentëve dhe stafit akademik në KUPV.

11. Pika V e Vendimit nr. 23, datën 16.12.2016 të Senatit Akademik, të ndryshoj dhe bëhet si më poshtë:

“Miratimin e Komisionit të Përhershëm të Këshillit Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, me këtë përbërje:

 1. Prof. Dr. Luan GJONÇAJ - Kryetar.
 2. PhD. Siri HOXHA - Zëvendëskryetar
 3. Prof. As. Dr. Engjëll LIÇAJ - Anëtar
 4. Prof. As. Dr. Bashkim VREKAJ - Anëtar
 5. Dr. Veronika DURMISHI - Anëtar
 6. Dr. Engjëllushe ZENELAJ - Anëtar
 7. Dr. Myzafer ELEZI - Anëtar
 8. Dr. Esmeralda HOXHA - Anëtar
 9. Dr. Rudina LIPI. - Anëtar
 10. Dr. Mallëngjim SKËNDERAJ - Anëtar
 11. Dr. Marjeta BONJAKO - Anëtar”.



12. Të miratoj propozimin e Rektorit të KUPV për pjesëmarrjen e detyruar të stafit akademik në aktivitetet shkencore (konferenca) të organizuara, sipas marreveshjeve të bashkëpunimit që KUPV ka me Qendrën EPICT Albania, dhe me Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT).
13. Të miratoj propozimin e Rektorit të KUPV për përfshirjen e detyruar të stafit akademik, me të paktën një artikull shkencor në vit, për botim në një nga dy numrat e Revistës Shkencore "Pavarësia".
14. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zëvendës Rektori, dekanët e Fakulteteve dhe Shefi i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe Shërbimet.
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. As. Dr. Luan GJONCAJ

